



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1.4, të Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 20, paragrafi 1 dhe paragrafi 3, pika 3.3 e Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas Kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Gjiçan, pas Rekomandimit të Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, 01.Nr.164/2016 të datës 14.09.2016 si dhe pas Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me datë 29.09.2016, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës

I.

Kuvendi i Komunës së Gjiçanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës lidhur me kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës - Dega në Gjiçan, për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës për nevoja të ndërtimit të xhamisë në fsh. Nasalë , Komuna e Gjiçanit.**

II.

Lejohet shfrytëzimi i sipërfaqes prej 1500 m² sipas paraqitjes grafike duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal, nga njësia kadastrale :

- P-70403045-00775-0, te vendi i quajtur “Golemi Rid”, lloji i njësisë- parcelë, lloji i pronës-pronë shoqërore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës 111589m² , shfrytëzimi aktual i parcelës – bujqësore kullosë e kl.1, e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjiçan.**

III.

Sipërfaqja prej 1500 m² ipet në shfrytëzim pa kompensim dhe ka dedikimin për nevoja të ndërtimit të xhamisë në fsh.Nasalë e cila do të shfrytëzohet nga ana e komunitetit fetar të cilët i zhvillojnë aktivitetet fetare në këtë xhami.

IV.

Afati i shfrytëzimit të kësaj sipërfaqe është 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

V.

Obligohet shfrytëzuesi i kësaj hapsire që të njejtën ta shfrytëzon dhe ta mirëmbajë si nikoqir i mirë me dedikimin për nevoja të xhamisë për zhvillimin e aktiviteteve fetare.

VI

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta bënë parcelimin e sipërfaqes të dedikuara për xhami në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal dhe njësinë e re kadastrale të krijuar pas parcelimit ta evidenton në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Gjilan.

VII

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VIII.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-98708
Gjilan, më 29.09.2016

Kryesuesja e Kuvendit,
/Valentina Bunjaku –Rexhepi/